

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E ENJTE 16 SHTATOR 2021

Përsëritje, zonja dhe zotërinj, qytetarë të Republikës së Shqipërisë!

Përsëritje, të nderuar kolegë deputetë!

Zonja Kryetare e Kuvendit, ju kërkoj ndjesë për emocionet, pasi është fjalimi im i parë! Dua ta nis fjalimin tim të parë në këtë foltore me një ndjesë dhe me një falënderim. Dua t'u kërkoj ndjesë të gjithë qytetarëve shqiptarë, të cilët më 25 prill besuan, si kurrë më parë, te Partia Demokratike dhe votuan besimin dhe shpresën për ndryshim, që u ulëm në karriget për të cilat ata na votuan, pasi nuk arritëm dot ta ndalonim tjetërsimin kriminal të votës së tyre më 25 prill. Të gjendur përballë të gjitha presioneve, të gjendur përballë pushtetit, i cili përdori çdo gjë, përballë institucioneve, të cilat, në fakt, duhet të ishin garantët e votës së lirë, por që bënë të kundërtën, ishin garantët e shitblerjes së votës dhe, rrjedhimisht, të vullnetit të shqiptarëve, ne sot jemi padrejtësisht, këtë e di e gjithë Shqipëria, të ulur në karriget e opozitës shqiptare. Ne qëndrojmë më të fortë se asnjëherë më parë, më të qëndrueshëm e stoikë për të përcjellë këtu zërin e qytetarëve shqiptarë dhe hallet e shqetësimet e shumta të tyre, gjë për të cilën na kanë votuar.

Ndërsa një falënderim shumë të rëndësishëm dua ta bëj sot për ata mijëra qytetarë shqiptarë, për qytetarët e qarkut të Fierit, veçanërisht të Divjakës, të Tërbufit, Grabjanit, Gradishtës dhe Remasit, të cilët, si asnjëherë më parë, votuan Partinë Demokratike, votuan programin e saj për ndryshim, për një Shqipëri më të mirë dhe që bindshëm përmbysën njëherë e përgjithmonë dogmën e Fierit, si hambari i votave të majta! Falënderimi shkon për të gjitha strukturat e Partisë Demokratike, veçanërisht ato të Divjakës, të cilat qëndruan stoike përballë këtij regjimi dhe përballë të gjithë pushtetit të përdorur në mënyrën më të pamëshirshme ndaj njerëzve të thjeshtë, ndaj njerëzve me vizion, ndaj njerëzve punëtorë që e duan Shqipërinë, por të zhveshur nga çdolloj pushteti në duart e tyre. Në zgjedhjet e 25 prillit Divjaka tregoi, me një rritje të rezultatit me 60% për Partinë Demokratike, si asnjëherë më parë se ajo qëndron mbi çdolloj përkatësi partiake të trashëguar nga e kaluara. Divjaka tregoi se ajo nuk i nënshtrohet asnjë regjimi, diktati e diktatori dhe se ajo e qytetarët e saj do të flasin përherë, përballë cilitdo pa frikë dhe pa zhurmë, por me votë qytetare masive. Për çfarë thashë më lart, ju jam pafundësisht mirënjohëse, falënderuese dhe, njëkohësisht, e ngarkuar me përgjegjësi për të qenë zëri juaj tani e në vazhdim. Në këtë mandat të vjedhur prej qytetarëve shqiptarë ky regjim vazhdon të recitojë të njëjtat fjalë dhe premtime boshe, sikundër 8 vjet më parë. I njëjti njeri që qëndron në krye, përgjegjësi kryesor për masakrën e 25 prillit, kërkon, me të njëjtat fjalë të vitit 2013, të stisë e të qëndisë atë që di të bëjë më së miri, propagandën e tij dhe të qeverisë së tij. Por kjo propagandë ka rënë njëherë e përgjithmonë dhe shqiptarët e dinë shumë mirë se ai dhe qeveria e tij nuk kanë asnjë vizion të ri për Shqipërinë.

Dëshpërues është fakti që dy fatkeqësitë më të mëdha të dy vjetëve të fundit u shiten shqiptarëve si arritje, madje për karriget e tyre personale, ata tentojnë të shtrëngohen pas tyre edhe për 4 vjetët e ardhshëm. Rindërtimi është shembulli i pastër sesi vuajtja e shqiptarëve përdoret për qëllime elektorale dhe përfituese të pushtetit, ndërsa pandemia nxori zbuluar brishtësinë e sistemit shëndetësor shqiptar shtetëror. Shumica e shqiptarëve po vuajnë në xhepat e tyre faturat e kripura të ilaçeve, ekzaminimeve dhe trajtimeve, ku shumica e tyre janë të siguruara privatisht. Shqiptarët provuan në shpinën e tyre se janë të zhveshur nga çdolloj përkrahjeje e shërbimi dhe, raste të tilla nuk

ka propagandë në botë që mund t'i mbulojë. Me kërshtëri kërkova të shoh programin e bujqësisë, pasi është specifik për Myzeqenë, për Divjakën dhe për pjesën më të madhe të popullsisë së zonës së Fierit, por nuk pashë asgjë të re, vetëm përsëritje e të njëjtit refren që prej 2013-ës. Në tre mandate radhazi premtohet naftë pa akcizë, por, në fakt, jepet vetëm naftë elektorale për të blerë vota; premtohet subvencion për fermerin, por përfitojnë vetëm ndërmarrjet e mëdha dhe investitorët e mëdhenj me përkatësi partiake rilindase, të cilat janë të lidhura ngushtë me pushtetin lokal e qendror, ndërsa pjesa tjetër e eksportuesve, qofshin këta të mëdhenj dhe, patjetër, të suksesshëm, etiketohen shpeshherë me gjuhë urrejtjeje si të ardhur, të cilët, pa dyshim, janë të përjashtuar nga çdo lloj skeme përfituese. Ndoshta është e vetmja qeveri në botë, e cila me paratë e taksave tona financon bizneset e kryebashkiakëve rilindës, të të afërmeve të tyre, të njerëzve të lidhur ngushtë me ta, të cilët janë edhe pjesë e nepotizmit të lidhur me pushtetin lokal. Kjo është ajo që ka ndodhur në Divjakë dhe rasti është shumë konkret. Kjo është e vetmja qeveri që nuk ka menduar kurrë për fermerin e vogël e të mesëm, që, në fakt, përbëjnë shumicën e fermerëve shqiptarë. Në rast se duhet të përmbledh gjendjen që ndodhet bujqësia shqiptare sot, duhet ta ndajmë atë në tri shtylla kryesore, e cila fillon me mbjelljen e prodhimeve, me shërbimet dhe me kalimin e tyre në tregun e shitjes. Kemi mungesë totale të përkrahjes për fermerin e vogël e të mesëm në subvencione, në naftë, në cilësinë, në çmimet e inputeve bujqësore dhe në kredi të buta.

Pra, shumica e fermerëve shqiptarë janë të lënë në harresë nga kjo qeveri dhe dua t'ju përmend rastin e ndodhur para pak ditësh të një fermieri nga Roskoveci, i cili i dha fund jetës së tij, sepse nuk arrinte dot të shlyente borxhet ku ishte zhytur për të mbjellë serrën e tij dhe për të mos shitur asgjë. Pse ndodh kjo?! Për shkak të politikave "shumë mirë" të aplikuara nga kjo qeveri. Kemi mungesa të infrastrukturës bujqësore, mungesa të rrugëve në parcela dhe mungesa të kanaleve kulluese e vaditëse, që, në fakt, në tenderë janë miliona euro, të cilat kanë shkuar për sistemin e vaditjes dhe sistemin e kanaleve kulluese, por realiteti është që fermieri shqiptar e vadit parcelën e tij dhe të mbjellat e tij me pompën me benzinë të blerë me 170 lekë litri, njësoj sa çmimi i benzinës për makinat luksoze. Edhe në rastet kur fermieri përdor energji elektrike, ai e blen me çmimin maksimal në treg, 16,8 lekë për kilovat në orë. Miliona euro janë shpenzuar për sistemin e kullimit të tokave të trumbetuara me të madhe, por që realiteti është krejt ndryshe. Këto ishin disa nga pikat që unë doja të ilustroja, për të cilat nuk ka absolutisht asgjë, vetëm propagandë.

Të nderuar deputetë, a e dini që në Divjakë në sezonin e shitjes së prodhimeve bujqësore, është shitur 1 kilogram patate 20 lekë të vjetër, 1 kilogram qepë 15 lekë të vjetër dhe, për më tepër, shalqiri i fushës u kalb në ara dhe nuk u shit asgjë prej tij? Fermieri shqiptar, ai vogël e i mesëm kryesisht, është drejt falimentit. Kur mbillet toka fermieri shqiptar, ai i Myzeqesë ka vetëm një lutje: "Shpresojmë të shitet".

Ndaj sot kam një thirrje për të gjithë ju, kolegë deputetë: ju lutem, kur të vini në Myzeqe, në hambarin e bujqësisë, fikini kamerat e propagandës, shikoni dhe prekni me duart tuaja realitetin për të ndihmuar së bashku bujqësinë, e cila është motori i ekonomisë, dhe fermerin shqiptar, si njeriu më i harruar, më i drejtë dhe punëtor në këtë vend! Faleminderit!